



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

STATUT MD-NR. 02/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
STATUTIT MD-NR. 06/2020
TË ODËS SË NDËRMJETËSUESVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS¹

¹ Statut MD-Nr.02/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e statutit MD-Nr. 06/2020 i odës së ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës a i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë më datë 13.02.2024

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare, nr. 14, 20 gusht 2018), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 së Republikës së Kosovës dhe nenin 19 të Statutit MD-Nr.06/2020 të Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës (21.09.2020), pas miratimit të ndryshimeve të Statutit nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve, në mbledhjen e mbajtur më 01 prill 2023 në Prishtinë,

Nxjerr:

STATUT MD-NR. 02/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT MD-NR. 06/2020 TË ODËS SË NDËRMJETËSUESVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij statuti është ndryshimi dhe plotësimi i Statutit MD-Nr. 06/2020 të Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës i cili është miratuar në Kuvendin e Përgjithshëm të Odës së Ndërmjetësuesve, në mbledhjen e mbajtur më 02 nëntor 2019 në Prishtinë, dhe është nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Drejtësisë më datë 21.09.2020 (Në tekstin e mëtejme: Statuti)

Neni 2

Paragrafi 2 i nenit 1 të Statutit, ndryshohet si në vijim:

2.Ndërmjetësuesit e licencuar, janë të organizuar dhe anëtarësuar në Odën e Ndërmjetësuesve, e cila vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Neni 5 i Statutit ndryshohet si në vijim:

Neni 5 Anëtarësimi

1. Oda përbëhet nga ndërmjetësuesit e licencuar në Republikën e Kosovës.

2. Anëtarësimi në Odë është i obliguar për Ndërmjetësuesit e licencuar në Republikën e Kosovës.

3. Regjistri i Ndërmjetësuesve, mbahet dhe përditësohet nga Ministria e Drejtësisë dhe Oda, duke u bazuar në Ndërmjetësuesit e licencuar dhe përmban të dhënat në pajtim me Nenin 23 të Ligjit për Ndërmjetësim.

Neni 4

Neni 8 i Statutit ndryshohet si në vijim:

Neni 8

Lartësia e anëtarësisë dhe kontributeve

1. Bordi i Odës i propozon Kuvendit të Odës, lartësinë e pagesës së anëtarësisë dhe kontributeve të detyrueshme të Ndërmjetësuesve.

2. Lartësia e anëtarësisë dhe kontributeve të detyrueshme të Ndërmjetësuesve caktohet varësisht nga nevoja për mjete për punën e Odës dhe në pajtim me planet vjetore të të hyrave dhe të dalurave të Odës.

3. Sipas vendimit të Kuvendit, për shumën e pagesës së anëtarësisë dhe kontributeve si dhe mënyrës së pagesës së saj, Ndërmjetësuesit paguajnë në llogarinë bankare të Odës, në fillim të vitit e më së largu deri më 31 Mars të çdo viti kalendarik.

4. Pagesa e anëtarësisë është e obliguar për të gjithë Ndërmjetësuesit e licencuar.

5. Për gjendjen financiare të Odës përpilohen raporte periodike dhe vjetore sipas kërkesës së Kuvendit të Odës.

Neni 5

Pas nenit 8 të Statutit shtohet nen i ri 8A, si në vijim:

Neni 8A

Kartelat e Ndërmjetësuesve

1. Të gjithë Ndërmjetësuesit, duhet të jenë të pajisur me kartela të afatshme anëtarësie të lëshuara nga Oda.

2. Anëtarët e Odës pajisen me kartelë me afat 1 vjeçar si Ndërmjetësues.

3. Përmbajtja e kartelës përcaktohet me vendim të Bordit të Odës.

Neni 6

Paragrafi 4 i Nenit 11 të Statutit ndryshohet si në vijim:

4.1 Mbledhjet e Kuvendit përgatiten nga Kryetari i Odës, duke bërë njoftimin me shkrim për të gjithë anëtarët e Odës për kohën, vendin dhe agjendën e Kuvendit:

4.2 mbledhjet e rregullta thirren së paku tridhjetë (30) ditë përpara

4.3 mbledhjet e jashtëzakonshme thirren së paku dhjetë (10) ditë përpara.

4.4 Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, në pamundësi fizike, mund të mbahen dhe online, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga Kuvendi.

Neni 7

1.Paragrafi 1 dhe 4 i Nenit 13 të Statutit ndryshohen si në vijim:

1.Kuvendi zgjedh anëtarët e Bordit me shumicën e votave të anëtarëve prezent . Bordi përbëhet nga shtatë (7) anëtarë që vijnë nga radhët e anëtarëve nga gjithsej 7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës që përfshijnë regjionin e: Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit dhe Gjakovës. Kryetari i Odës është anëtar i Bordit sipas detyrës zyrtare pa të drejtë vote. Përzgjedhja e anëtarëve të bordit duhet të bëhet me votim të fshehtë me kundër kandidat për secilin regjion përkatës.”

4.Mandati i anëtarëve të Bordit është tre (3) vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

Neni 8

Paragrafi 4 i nenit 14 të Statutit, ndryshohet si në vijim:

4.Mandati i Kryetarit të Odës është tre (3) vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

Neni 9

Paragrafi 2 i nenit 15 të Statutit ndryshohet si në vijim:

2.Iniciativa për zëvendësimin e kryetarit të Odës mund të jepet nga më së paku 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Borit të Drejtorëve, apo nga më së paku 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Odës.

Neni 10

Pas nenit 19, shtohet neni i ri 19A si në vijim:

19A

Mandati i Kryetarit të Odës dhe anëtarëve të Bordit

Pas hyrjes në fuqi të këtij statuti, mandati tre (3) vjeçar i Kryetarit të Odës dhe anëtarëve të

Bordit, vlen për anëtarët e zgjedhur pasi të kalojë mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit aktual.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

13/02/2024